REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.6572 Prot.

Maliq më 02.11.2026

VENDIM

Nr.129, datë 30.10.2026

PËR
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI "SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË", PËR STREHIM

Bazuar ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr.453, datë 03.07.2019 "*Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët , me kredi të lehtësuara nga shteti*", ndryshuar me vendimin nr. 268, datë 29.4.2022, VKM nr.301 datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët*", VKB nr. 139, datë 26.11.2025 "*Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*", VKB nr.91 datë 31.08.2023 për "*Miratimin e rregullores për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në bashkinë Maliq*", Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.158 datë 26.03.2024 "*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisë Maliq*" si dhe Vendimin nr.04 datë 14.04.2026 të Komisionit të Strehimit bashkia Maliq, mbi "*Miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehim*", Këshillit i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë familjen me kryefamiljar Z. Ilir Shaban Ahmeti, si përfitues të programit "Subvencioni i Interesave të Kredisë", për Strehim, sipas tabelës nr.1 bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Strehimit, Bashkia Maliq.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.11.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ